



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1394/24 Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
  - *Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturës BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 200 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e riakreditimit.
- III. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimet e bartësve bëhen me vendim nga KSHC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me bartësit e programeve si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inxhinieri e Ndërtimit dhe infrastrukturës BSc 180 ECTS</i>	Anjeza Alaj Feti Selmani Muhamet Ahmeti Bekim Selimi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT kampusi kryesor.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. **Për programin e studimit; Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturës BSc 180 ECTS**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Philippe Bouillard, Ivana Milicevic dhe Nadia Manzoni është organizuar më 16.04.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) dhe Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit.

Për shkak të numrit të vogël të fushave të standardeve të përmbushura plotësisht në vlerësimin e programit *Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturës BSc 180 ECTS*, KSHC ka vendosur që kohëzgjatja e akreditimit për këto programe të jetë tri (3) vite.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të mbajtur më datë 25.06.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegji UBT kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

  
Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së